



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA RROGOZHINË  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2057.Prot.

Rrogozhinë, më 22.05.2026

**NJOFTIM**

Në mbështetje të pikës 4, nenit 53 të Ligjit Nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit Bashkiak Rrogozhinë”, njoftoj thirrjen e mbledhjes së radhës të Këshillit Bashkiak e cila **do të zhvillohet në sallën e mbledhjeve të Këshillit, ditën Enjte datë 28.05.2026 ora 13:30<sup>oo</sup>**, me rendin e ditës si më poshtë :

- 1- Miratim i rendit të ditës.
- 2- Miratim i procesverbalit Nr.5, të mbledhjes së Këshillit Bashkiak datë 15.04.2026.
- 3- Miratim i projekt - vendimit, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Mars 2026 nga fondi i Bllok - Ndihmës 6%”.
- 4- Miratim i projekt - vendimit, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Maj 2026 nga fondi i pushtetit vendor”.
- 5- Miratim i projekt - vendimit, “Për miratimin e tavanëve përgatitore të shpenzimeve për programin buxhetor afatmesëm të bashkisë Rrogozhinë për vitet 2027-2029.
- 6- Miratim i projekt- vendimit, “Për përdorimin e fondit të emergjencave civile”.
- 7- Miratim i projekt-vendimit, “Për miratimin e Plan Masash ‘Për parandalimin dhe menaxhimin e zjarreve masat që duhet të merren për mbrojtjen e pyjeve dhe kullotave bashkiake nga zjarret’ “.
- 8- Njohje me planin operacional vjetor 2026-2027, “Për administrimin e pyjeve dhe të kullotave të Bashkisë Rrogozhinë”.
- 9- Raport nga drejtoria e bujqësisë , mbi masat e marra për sistemin e kullimit dhe vaditjes dhe për gjendjen e rezervuareve në territorin e bashkisë Rrogozhinë.
- 10- Raport, mbi veprimtarinë e Qendrës Kulturore “Haxhi Memolla” për vitin 2025 si dhe aktivitetet e parashikuara për vitin 2026.
- 11- Informimi i Këshillit Bashkiak mbi “ Parandalimin e Dhunës me bazë gjinore”.
- 12- Informacion nga policia e shtetit mbi rendin dhe sigurinë publike në bashkinë Rrogozhinë.
- 13- Raport nga Drejtoria e Bujqësisë mbi masat e marra për korrjen e të lashtëve dhe masat e marra ndaj zjarrit në Bashkinë Rrogozhinë.

(vijon)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA RROGOZHINË  
KËSHILLI BASHKIAK

- 14- Shqyrtim i Informacionit “Mbi punën e bërë nga sektori i MZSH-së për periudhën Maj 2025- Prill 2026 dhe propozime për kompletimin me mjete dhe pajisje për përmirësimin e këtij shërbimi”.
- 15- Shqyrtim i kërkesës për informacion dhe ndërhyrje institucionale të anëtarit të këshillit bashkiak z. Mitat Daja.
- 16- Të ndryshme.
  - Shqyrtim i ankesës së një grupi qytetarësh mbi problematikën e kanalit e segmentit Peqin -Kavajë.
  - Shqyrtimi i kërkesës së z. F.Rexhepi.
  - Të tjera.

**Mbledhjet e Komisioneve të KB**, si më poshtë :

- Njoftoj të mbledhet ditën e Martë datë 26.05.2026 ora 13 : 00<sup>oo</sup>, Komisioni i Financës, Taksave dhe Revizionimit, me këtë përbërje : Alime Hoxha - Kryetare, Merilin Saraçi - Zëvendëskryetare, Enver Memolla -Anëtar, Gëzime Met-hasani - Anëtare, Indrit Dedej - Anëtar.
- Njoftoj të mbledhet ditën e Martë datë 26.05.2026 ora 13 : 30<sup>oo</sup>, Komisioni i Shërbimeve Publike, Bujqësi, Blegtori dhe Pronave, me këtë përbërje : Lulzim Hasa - Kryetar, Dhurata Meka - Zëvendëskryetare, Fatmira Thartori - Anëtare, Altin Tosku - Anëtar, Hekuran Xhani - Anëtar.

**Shënim :**

- Pikat 5, 8, 9, 10, 11, 12 dhe 16 shqyrtohet i njëjti material i vënë në dispozicion në mbledhjet paraardhëse të KB.
- Cilido komision tjetër që e konsideron të arsyeshme për t’u mbledhur dhe për të shqyrtuar një apo disa pika të rendit të ditës është i lutur të kordinojë me Sekretarin e Këshillit Bashkiak.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

ZËVENDËSKRYETAR I KËSHILLIT  
ERIND TOSKU

